



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.795/2 prot.,

Datë 19.04.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetary*”, me Nr. REF-REF-19625-02-14-2022, me objekt Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve te Perqendruara.

Ankimues: “REJ” SHPK
Zogu i Zi, Qatar Center Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

Në datën 15.04.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.795 prot e operatorit ekonomik Rej shpk për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetary*”, me Nr. REF-REF-19625-02-14-2022, me objekt Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Rej shpk nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti*

kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik Rej SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se shërbimet e mëparëshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Furnizimet e mëparëshme, të paraqitura në SPE nga ofertuesi, kanë si objekt pastrimin e rrugëve, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për qytetet Pogradec, Perrenjas, Vlore si dhe shërbime të tjera mirëmbajtje të cilat nuk përbëjnë përvoja të mëparëshme të ngjashme me objektin e prokurimit (shërbim pastrimi i ambjentëve të brendshme dhe të jashtme të godinës).*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur në tabelën e punonjesve, të dhëna mbi kontraktimin e 38 punonjësve sanitarë nga gjithsej 42 të kërkuar në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim. Punonjesit sanitarë të deklaruar në listën e stafit nga ofertuesi në nr. rendorë 42 deri 51, rezultojnë të mos jenë të kontraktuar sic kërkohej në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim.*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon në pronësi ose me qera “dy makina larëse për ambjentet e brendshme”. Për këtë kërkesë Ofertuesi ka paraqitur një kontratë blerje me kusht me subjektin Globi sh.p.k nga ku rezulton se kjo e fundit ka ende pronësinë e makinave larëse, në kundërshtim me kërkesën e AK ku kërkohej shprehimisht që subjekti ofertues të disponojë në pronësi ose qera mjetet e kërkuara në momentin e hapjes së ofertave.*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 3/3, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon Makinë për larjen e rrugëve (Autobot) sipas kërkesave të AK. Nga leja e qarkullimit e paraqitur në SPE për autobotin AB048CF, rezulton se ky i fundit është dhënë me qira, pra nuk disponohet nga ofertuesi. Ndërsa, autoboti me targë AA294FF, referuar fotos se paraqitur, nuk rezulton të jetë sic kërkohej në DST, i pajisur me pompe për larjen e rrugëve me presion dhe i pajisur me tub për nxjerrjen e ujit në pjesët anësore të tij.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 19.04.2022

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**